Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 255/19
Datë/Datum 12.06.19
PRISHTINE - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit KK Fushë Kosovë OE ankues "ENGRUP " SH.P.K	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Es'heme Beka – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr. 255/19 të parashtruar nga OE"ENGRUP " SH.P.K-Prishtinë		
Datë	**12.06.2019**		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e dt:28.05.2019 me nr. 255/19të parashtruar nga OE"ENGRUP " SH.P.K-Prishtinë, lidhur me aktivitetine prokurimit "Ndertimi i Qendres per Mjeksi Familjare ne F ushe Kosove"me nr. të prokurimit: 612/19/2090/5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KK Fushë Kosovë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues –Fushë Kosovë(KK).
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

RAPORTI I *EKSPERTIT SHQYRTUES*

		05.06.2019	**12.06.2019**
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të ekspertit.*	*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

1). Me datën: 28.05.2019 OE "ENGRUP " SH.P.K-Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP , , kundër njoftimit mbi vendimin e AK-se kuështë rekomanduar për kontratë OE "N.N Prishtina-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i Qendres per Mjeksi Familjare ne Fushe Kosove" me nr. të prokurimit: 612/19/2090/5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Fushë Kosovë.

Konform nenit113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues"ENGRUP " SH.P.K-Prishtinë.

- Dispozitat e shkelura sipas OE ankues""ENGRUP " SH.P.K-Prishtinë., janë
- Neni 1 - paragrafi 1 – Qëllimi i ligjit
- Neni 7 - Barazia në trajnim/jo-diskriminimi
- Neni 59. - Ekzaminimi, Vleresimi dhe krahasimi i tendereve;
- Neni 60 - Kriteret për dhënien e kontratës.
- Neni 69- Aftësia teknike dhe professionale;

Të LPP gjatë procedurave të vlerësimit të dosjes së tenderit të lartëpërmendur.

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Këtu vendosen të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues, që janë shënuar në ankesë

- Pas njoftimit të Autoritetit Kontraktues përmes e-prokurimit **"Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm" ngase tenderi juaj nuk qe me i favorshmi nga aspekti ekonomik, nuk qe tenderi me çmimin më të ulët ",** kompania ENGRUP shpk me datën 20.05.2019 ka bërë kërkesë për qasje në dokumente të konpanisë NN " PRISHTINA " e shpallur fituese nga Autoriteti Kontraktues dhe me datën 21.05.2019 është bër takimi për qasje në dokumente të kompanisë në fjalë, na është lejuar shikimi i dokumentacionit tenderues të kompanisë NN " PRISHTINA " dhe në fund të kemi kërkuar një kopje të dokumentacionit.
- Me datë22.05.2019 kemi dorëzuar në formë elektronike Kërkesën për Rishqyrtim.
- Me datë 24.05.2019 kemi pranuar nga Autoriteti Kontraktues vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim, në këtë vendim është refuzuar kërkesa jonë për rishqyrtim.

Gjatë kontrollimit të dokumentave kemi verejtur se nuk janë respektuar (janë shkelur) Nenet si me poshtë:

1. Nuk është respektuar **Neni 1 paragrafi 1 e LPP-së** (Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike).
2. Nuk është respektuar **Neni 7 paragrafu 1e LPP-së**(Autoriteti Kontraktues do ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente).
3. Nuk është respektuar **Neni 59 paragrafi 4 e LPP-së**(Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjithshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit).
4. Nuk është respektuar **Neni 60 paragrafi 1, pika 1 e LPP-së** (Autoriteti Kontraktues do të ja japë kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose; 1.1 tenderin e përgjithshëm me çmimin më të ulët).
5. Nuk është respektuar **Neni 69 e LPP-së.**Aftësia teknike dhe/ ose profesionale,

- **Autoriteti kontraktues në dosje të tenderit ka kërkuar:**
  Kërkesat mbi mundesitë teknike dhe/ ose profesionale, pika 9.1
  Kaspaciteti teknik dhe profesional:
  1. **Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerë prej min.510,000,00€**

  Dëshmia e kërkuar dokumentare
  1. **Një lisrtë të kontratave të realizuar në tri vitet e fundit duke saktsuar produktet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit të përcjella me referenca përkatëse ose porceset e pranimeve – kopje.**

Ne kemi verejtur se konpania e shpallur fituese NN " PRISHTINA " nuk e plotëson këtë krites siq është kërkuar në dosje të tenderit, kompania në fjalë ka një listë të kontratave në të cilen janë disa kontrata me vjetra se tri vite, disa kontrata të pa përfunfuara, që nuk kanë pranime teknike apo referanca dhe nuk munden të llogariten si të përfunduara.

Konpania fituese NN " PRISHTINA " vlera e të gjitha kontratave që ka paraqitur në dosje të tenderit, në listen e paraqitur është 411,596.66€, edhe ne keto kontrata jan disa pune te kryera ne vitin 2015, qe nuk jan te vlefshme , edhe kjo vlerë do të zvogëlohet.

- Prandaj kompania jonë ENGRUP shpk, kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, të bejë shqyrtimin e dokumenteve të dosjes për tenderin e lartëpërmendur dhe deshmive të ofruara nga Kompania ENGRUP

shpk.
Po ashtu, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, të kerkojë nga Autoriteti Kontraktues që të anulojë Njoftimin për dhënien e kontratës dhe lëndën të kthejë në **Rivlerësim.**

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë: 12. 04. 2019

Lloji i procedurës së aplikuar:.....Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:..... ...., punë

Vlera e parashikuar e kontratës:..... 340.000,00€

Kriteri për dhënie të kontratës(N.52).....tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave..... 07.05.2019

Data e hapjes së ofertave..... ..... 07.05.2019

Data e përfundimit tëvlerësimit të ofertave..... 17.05.2019

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar apo të pa suksesshëm..... 17.05.2019

Data e njoftimit për dhënien e kontratës:..... 17.05.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim..... 22.05.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....24.052019

Kriteret për vlerësim:

Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1.Përstatshmëra e OE me kërkesat e nenit 65 të Ligjit Nr.04 L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092	**1. Deklarata nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e Aneksi 2 në dosjen e tenderit.**
2. Vertetimi nga ATK-ja	**2. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit (duhet të dorëzohet nga tenderuesi që propozohet për dhënje të kontratës –kopje.**
3. Vertetimi nga Gjykata	**3. Një vërtetim nga autoriteti kompetent**

	gjyqësor i vendit te themelusit të tenderuesit (GjTHK) se tenderuesi nuk ka pengesa lidhur me Kërkesat e pershtatshmerise Pika 6.2 .nën a,c,d,e,f dhe pika 6.3 nen a.b. dhe d. të dosjes se tenderit jo me te vjeter se 6 (gjashtë) muaj nga data e fundit te dorezimit te tenderit (duhet të dorëzohet nga tenderuesi që propozohet për dhënje të kontratës- origjinali ose kopje e noterizuar)
Përshtatshmëria profesionale: **1.Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e juaj të themelimit me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend – kopja e çertifikatës së biznesit.**
2.Çertifikata e numrit fiskal.	**2.Kopja e çertifikatës së numrit fiskal nëse nuk është e përfshirë në çertifikatën e biznesit.**
3.Çertifikata e regjistrimit për TVSH	**3. Kopja e çertifikates se regjistrimit për TVSH (deklarues).**
Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kapaciteti teknik dhe professional: **1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontratë në vlere prej min. 510000.00 €**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **1. Një listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktsuar produktet e perfshira, shumen e kontrates, daten dhe pranuesit te percjella me referenca perkatese ose proceset e pranimeve – kopje.**
2.Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshem që do të angazhohet në këtë projekt,(min. 10 punetore). a. OE duhet te ket një inxhinjer te diplomuar te ndertimtaris-drejtimi konstruktiv apo bachelor me min.tri vite pervoje pune pas diplomimit. b. OE duhet te ket një inxhinjer te diplomuar te ndertimtaris-drejtimi hidrroteknik apo bachelor me min.tri vite pervoje pune pas diplomimit. c. OE duhet te ket një inxhinjer te diplomuar te elektroteknikes - drejtimi elektroenergjetik apo bachelor me min.tri vite pervoje pune pas diplomimit.	**2.Një pasqyrë tabelare e personelit Emrin,Mbiemrin,Profesionin,Eksperienca dhe pozicioni të angazhuar me parakontratë në kompani , duhet të dorëzohet në origjinal i nënshkruar dhe i vulosur nga OE Per piken a., b., c. duhet te deshmohet me kopje te diplomes universitare te noterizuar ,kontraten e punes apo parakontrate, leterreference nga punedhenesi ose qfardo dokumenti tjeter qe deshmohet per punet dhe pervojen e meparshme inxhinjerike ne lemin e caktuar (rikonstruktim,ndertim ,renovim)**
3. OE duhet të emëroj me vendim menaxherin e projektit	**3.OE në kuadër të stafit duhet të emëroj menaxherin e projektit i cili duhet të jet inxhinjer i ndërtimtaris -konstruktiv ,me së paku tri vite përvojë pune në profesion**

	e dëshmuar me CV, diplomën mbi kualifikimin, vërtetimin mbi përvojën e punës ,të jet në listën e të punësuarve ose të ketë marrëveshje bashkëpunimi .
4.OE duhet të posedoje paisje teknike të nevojshme(min.një kamiona min 10 ton,min. nje skiper,	4.Një listë të mjeteve apo paisjeve teknike qe janë në dispozicionin tuaj për te ekzekutuar kontraten në fjalë- paisjet dhe makineria në dispozicion duhet të deshmohen me kopje të librezave mbi pronsin e tyre ose DUD-I doganore, ose fatura e blerjes ose kontrata mbi qiramarrjen të dorzohen në kopje të qarte dhe të lexueshme.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi €	Vërejtje
1.	GOE " DETARI " SH.P.K; BLENDI COLOR" N.N.SH GJASHTE VELLEZRIT BATATINA"	BATLLAVË	289.922,50	JO
2.	GOE "CON-DES " SH.P.K; "JETMIRI "SH.P.K; N.N.P " EURO CONSRUCTION"	PRISHTINË	284.050,30	JO
3.	GOE "OSMANI HOLDING "SH.P.K.; N.T.P FERIZI,	TORIN	287.815,95	JO
4.	ENGRUP SH.P.K	PRISHTINË	258.524,20€	JO
5.	GEO N.N.P "VETONI"; "T DESIGN" SH.P.K	RAHOVEC	311.342,65€	JO
6.	AAGPROJEKT" SH.P.K	PRISHTINË	294.625,00€	JO
7.	GOE " IM-IMERI GROUP " SH.P.K; ENGGROUP SH.P.K	PRISHTINË	333466,00 €	JO
8.	"NBT-ING" SH.P.K	SHIROK	315.527,80€	JO
9.	MURATORI" SH.P.K	DRENAS	313.491,20€	JO

10	"A CON"SH.P.K	PRISHTINË	278.782,80€	JO
11.	N.N PRISHTINA	PRISHTINË	246.878,00€	JO
12.	"TERMOMONTIMI"SH.P.K	PRISHTINË	295.896,30€	JO
13.	"MERCOM COMPANY SH.P.K	PRISHTINË	319.790,20€	JO
14.	"KOMPANIA PRISHTINA" SH.P.K	PRISHTINË	324.324,00€	JO
15.	"GOE OLTAND GROUP"SH.P.K; EDONA SH.P.K; N.N.SH "ABCONSCTRUCTION"	SUHAREK	269.976,90€	JO
16.	GOE"LIRIGZONI SH.P.K;"LIRIGZONI S "SH.P.K	SKENDERAJ	300.525,40€	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.
Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Donat Zharku– Kryetar i komisionit
- Besa Budakov–Anëtar i komisionit
- Milanka Bojkovic– Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Duke ubazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni vlersues pas ekzaminimit, krahasimit dhe kontrollit te ofertave i rekomandon zyrtarit te prokurimit qe projektin "Ndertimi i Qendres per Mjeksi Familjare ne Fushe Kosove" ta kryej OE N.N Prishtina-Prishtinë pasi qe ka ofruar cmimin me te ulët dhe është i përgjegjeshemme me dokumentaionin e kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin per kontrate.

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues

EMRI I OPERATORËVE EKONOMIK QË KANË DORËZUAR TENDER TE PËRGJEGJSHËM	VENDI	Çmimi
N.N Prishtina	Prishtinë	246.878,00€

ENGRUP SH.P.K	Prishtinë	258.524,20€
"GOE OLTAND GROUP"sh.p.k; EDONA SH.P.K; N.N.SH "ABCONSCTRUCTION"	Suharek	269.976,90€
"A con"sh.p.k	Prishtinë	278.782,80€
GOE "Con-Des " sh.p.k; "Jetmiri "sh.p.k; N.N.P " Euro consruction"	Prishtinë	284.050,30
GOE "Osmani Holding "sh.p.k.; N.T.P Ferizi,	Torinë	287.815,95
GOE " Detari " sh.p.k; BLENDI COLOR" N.N.SH Gjashte Vellezrit Batatina"	Batllavë	289.922,50
AAG Projekt" sh.p.k	Prishtinë	294.625,00€
"Termomontimi"sh.p.k	Prishtinë	295.896,30€
GOE"Lirigzoni sh.p.k;"Lirigzoni S "sh.p.k	Skenderaj	300.525,40€
GEO N.N.P "Vetoni"; "T Design" sh.p.k	Rahovec	311.342,65€
Muratori" sh.p.k	Drenas	313.491,20€
"NBT-ING" sh.p.k	Shirokë	315.527,80€
"MERCOM COMPANY SH.P.K	Prishtinë	319.790,20€
"Kompania Prishtina" sh.p.k	Prishtinë	324.324,00€
GOE " IM-IMERI GROUP " sh.p.k; Enggroup sh.p.k	Prishtinë	333466,00 €

- Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardhë në përfundim se 16 OE ofertues janë të përgjegjshëm dhe kanë rekomanduar për kontratë"**N.N "Prishtina"**–Prishtinë, me çmim prej: **246.878,00€**

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Engrup" sh.p.k-Prishtinë.

Përgjigje nëPretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues,se OE i rekomanduar per kontrat N.N " PRISHTINA " nuk i ploteson Kërkesat mbi mundesitë teknike dhe/ ose profesionale, pika 9.1, siq jan kërkuar në dosje të tenderit, kompania në fjalë ka një listë të kontratave në të cilen janë disa kontrata me te vjetra se tri vite, disa kontrata të pa përfunfuara, që nuk kanë pranime teknike apo referanca dhe nuk munden të llogariten si të përfunduara.
Konpania fituese N.N " PRISHTINA " vlera e të gjitha kontratave që ka paraqitur në dosje të tenderit, në listen e paraqitur është 411,596.66€, edhe ne keto kontrata jan disa pune te kryera ne vitin 2015,

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne kerkesat e AK ku **ne** dosjen e tenderit dhe njoftimin per kontrat ka qene:
Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontratë në vlere prej min. 510.000.00 €.
Eksperti shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar per kontrat ne oferten e tij ka te bashkangjitur list e kontratave të realizuara dhe disa rapotrt/referenc po ashtu me daten 13.05.2019 AK Komuna Fushë Kosovë duke u bazuar ne nenin 69 të LPP-së, dhe sqarimet ne nenin 39.8 te RRUOOP-se përmes platformes elektronike ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontrat. Ne sistemin elektronik te dokumentet tjera me dt. 15.05.2019 jan ngarkuar disa raporte te pranimit dhe nje deklarat nga OE N.N Prishtina ku ka plotesuar dokumentacionin (*ka sjell deshmi referenca/raporte*) duke u bazuar ne nenin 69 te LPP-se dhe ne sqarimet e RRUOPP-se neni 39.8 ku thot :

39.8 *Mungon referenca /certifikata e pranimit nga lista e kontratave te prezantuara.* ***Mund të kërkonen informata sqaruese.***

Prandaj duke i mbledhur të gjitha vlerat e prezantuara në oferten e dorzuar dhe në dokumentin e ngarkuar në platformen E- prokurim pa i llogaritur vlerat e kontratave të viteve të me hershme dhe ato të cilat nuk jan dëshmuar me referenca/raport, vlera e kontratave të realizuara dhe të deshmuara me raport/referenc arrin vlerën prej **607,081.69**, qe plotesojn kriterin e vendosur nga ana e AK-se.
Duke u bazuare ne sqarimet me lart AK ka respektuar LPP- në dhe RRUOPP-në. Nga ajo qe u tha me lart eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor **është i pa bazuar.**

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtuesi propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e pa bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin nr.1), dhe te mbetet ne fuqi Vendimi i Autoritetit Kontraktues KK Fushë Kosovë.